



**Rama: Konsultime me fermerë e sipërmarrës bujqësorë për të ndërtuar modellet e duhura në fshat**

Faqe 2



**Standarde sipas BE-së/ ITC program të plotë trajnimi dhe asistencë teknike për 10 SME eksportuese të vajit të ullirit**

Faqe 5



**Albaponik, revolucionarizimi i bujqësisë së qëndrueshme në Shqipëri me mbështetjen e BE-së**

Faqe 11



# AGROBIZNESI

**BOTIM I KËSHILLIT TË AGROBIZNESIT SHQIPTAR**

Adresa: Rruga "Mine Peza", Pallati 87/3, Hyrja 1, Kati i parë, Tel/ Fax: 2229445  
E-mail: infokash@yahoo.com www.kash.org.al

**FED invest**

Rr. "Qemal Stafa", P. 9-katësh,  
Nr. 70, Kati 2, Pazari i ri, Tiranë.  
Tel: +355 4 2 251 910 /911  
Email: info@fedinvest.al  
kontakt@fedinvest.al  
www.fedinvest.al

15-ditëshi i dytë i muajit qershor 2025

**Viti i shtatëmbëdhjetë i botimit - Nr. 512**  
Çmimi 125 lekë

E përdyjavshme e pavarur

## PËRDORNI CERTIFIKIMIN DHE TRAJNIMET PËR TË PROMOVUAR PRODUKTET TUAJA NË TREGJET NDËRKOMBËTARE

# NJË UDHËZUES PRAKTIK PËR EKSPORTUES, GRUMBULLUES DHE ORGANIZATA QË DUAN TË SHFRYTËZOJNË CERTIFIKATAT DHE PËRVOJAT E TRAJNIMIT PËR TË NDËRTUAR BESIM DHE PËR TË HYRË NË TREGJE TË REJA ME KËRKESA TË LARTA

Organizata e Kombeve të Bashkuara për Zhvillim Industrial (UNIDO), përmes Programit Global për Cilësi dhe Standarde (GQSP), të mbështetur nga Qeveria Zvicerane përmes Sekretariatit Shtetëror për Çështjet Ekonomike (SECO), po mbështet fermerët dhe ndërmarrjet e vogla e të mesme (NVM) në përmbushjen e standardeve të kërkuara, duke lehtësuar aksesin e tyre në tregjet evropiane dhe ndërkombëtare

**GQSP ALBANIA**  
GLOBAL QUALITY AND STANDARDS PROGRAMME

**Programi Global Për Cilësi dhe Standarde**

**UNIDO**  
UNITED NATIONS INDUSTRIAL DEVELOPMENT ORGANIZATION

Schweizerische Eidgenossenschaft  
Confédération suisse  
Confederazione Svizzera  
Confederaziun svizra

Sekretariati i Shtetit për Çështjet Ekonomike SECO



**Ministria e Bujqësisë: 4 vatra të murtajës me 716 bagëti të prekura, ndalohet tregtimi në tregjet e kafshëve të gjalla**



Faqe 4

## **BKFSH**

### Të luftojmë "tre armiqtë" e fermerit

Fermeri është e vetmja shtresë që ka shumë nevojë për ndihmë. Megjithatë, fermeri është në natyrë, atë e rrezikojnë shumë probleme në mes tyre vetë Natyra. Ndër tre armiqtë kryesorë janë:

1. Moskullimi i tokës,
2. Thatësira,
3. Erozioni dhe përmbytja

Faqe 7



**Instalimi i stacioneve elektronike të motit për bujqësinë, janë investime të mirëpritura, por vetëm nëse përdoren në praktikë janë të dobishëm**

Prof. Ass. Enver Isufi, Agronom në Mbrojtjen e Bimëve dhe Bujqësinë Biologjike

Faqe 10

## TEMA TË DITËS

- Pensionistëve "u gjendet punë" në bujqësi! - Nëse aplikojnë për subvencione, do të jenë automatikisht përfitues Fq.2
- Qeveria miraton formularët e kërkesës për përdorim të burimeve ujore Fq.6
- Skema Kombëtare e Investimeve, fermeri nga Peqini shtoi mekanikën bujqësore Fq.4
- Rama: Bashkitë i kanë mundësitë të krijojnë kompani ndërtimi Fq.7
- Denaj: Skema Kombëtare e Investimeve fuqizon feramat familjare Fq.11

## ULLISHTARI

**Protokolli i mbrojtjes së integruar i ullirit**

Prof. Dr. Shpend Shahini



Faqe 6

## AKTUALITET

# Rama: Konsultime me fermerë e sipërmarrës bujqësorë për të ndërtuar modelet e duhura në fshat

Kryeministri Edi Rama zhvilloi një bashkëbisedim me fermerë e sipërmarrës në fushën e bujqësisë për të dëgjuar problemet dhe idetë e tyre si dhe për të ngritur një urë të re bashkëpunimi në funksion të rrugës së anëtarësimit të Shqipërisë 2030 në BE.

Në fjalën e tij, Rama u shpreh se arsyeja e takimit ka të bëjë me nevojën për të dëgjuar nga

“Në mënyrë sporadike kemi mundur të informohemi për gjëra që në pamjen e parë janë shumë të thjeshta, por fatkeqësisht janë jashtë rrezes së vëmendjes dhe të leximit nga ana

plotësisht në një hapësirë informale, pasi kjo mesa kuptoj unë ka munguar edhe na mungon”.

Patjetër, shtoi Rama, “që pas këtij diskutimi do të mundohemi të gjejmë rrugët sesi ky kontakt i vazhdueshëm të jetë më i frytshëm, më garantues për dëgjimin e zërit tuaj edhe

që edhe kjo është një hallkë e dobët e jona në qeverisjen e fshatit, pasi qysh se është bërë reforma administrative-territoriale dhe bashkitë janë zgjeruar me përmasën e hapësirës rurale, në vend që kjo të sillte një rritje të vëmendjes dhe një rritje të mundësive

jetër të garantojmë një kthesë në këtë drejtim sepse ende sot nuk kemi asnjë ndërmarrje të vetme bujqësore të krijuar me kontributin dhe me bashkëpunimin e fermerëve, të sipërmarrësve dhe të strukturave të pushtetit vendor. Janë bërë disa tentativa por faktikisht nuk mund të themi se kemi krijuar një model”, tha Rama.

kjo e kombinuar bashkë me garancinë sovranë që është prej kohësh në dispozicion të fshatit, nuk kanë sjellë dhe gjasat janë që të mos sjellin asnjë rezultat domethënës në rast se ne nuk ndryshojmë qasjen. Dhe kur them ne nuk kam parasysh juve që jeni në sallë, por kam parasysh ne që jemi në politikëbërje dhe në vendimmarrje”.

Për të ndryshuar këtë qasje, shtoi Rama, “na duhet një bashkëpunim më i afërt me protagonistët që janë në fushën e përpjekjes së përditshme në fshat dhe na duhet



më afër dhe në një mënyrë më të strukturuar këndvështrimet sipas fushave të ndryshme të aktivitetit në këtë territor.

“Gjatë gjithë periudhës së fundit të kontakteve intensive me njerëzit në fshat, për shkak të procesit elektoral kemi krijuar ndjesinë që jemi në nevojën për t’u afruar më shumë dhe për të dëgjuar më shumë nga jeta e përditshme reale e njerëzve që jetojnë dhe punojnë dhe zhvillojnë aktivitetin e tyre të sipërmarrjes në fshat”, u shpreh Rama.

e qeverisë dhe nga ana e strukturave tona vendimmarrëse dhe shkaktojnë konsum të madh energjie dhe patjetër edhe konsum të pafrytshëm të kohës suaj që është njëkohësisht edhe koha e vendit”, tha Rama.

Kreu i qeverisë, theksoi se, “arsyeja pse e kemi ndërtuar këtë diskutim, këtë tryezë të përbashkët diskutimi në një formë tjetër nga ato të zakonshmet është pikërisht sepse duam që diskutimi të shtrihet në çdo detaj edhe që opinioni juaj të mund të shtjellohet



patjetër edhe më i dobishëm në funksion të politikave dhe vendimmarrjeve tona”.

“Ne kemi bërë një përzgjedhje të bazuar tek profilet e ndryshme të sipërmarrjes në fshat edhe natyrisht bazuar në një gjeografi të bazuar ku kemi marrë opinionet e drejtuesve tanë të qarqeve, por nga ana tjetër kemi ftuar këtu edhe disa drejtues të pushtetit vendor, duke pasur parasysh

për fermerët dhe për sipërmarrjen në fshat ka sjellë një shkëputje”, tha Rama.

Kryeministri shtoi se, “në një masë të madhe kryetarët e bashkive e shikojnë fshatin si çështje të urbanizimit, si çështje të infrastrukturës rrugore, të pastrimit, të ndriçimit, por nuk e shikojnë si pjesë të punës së tyre të përditshme, në funksion të zhvillimit dhe jemi në një pikë ku duhet pat-



Ndërkohë, shtoi kreu i qeverisë, “kemi vendosur në dispozicion të fermerëve dhe të fshatit edhe një linjë të re kredie nga Banka e Shqipërisë, 250 milionë euro, që është një shumë kolosale për t’iu përgjigjur ambicieve dhe për t’i dhënë mbështetje projekteve në fshat, por që

një plan për të ndërtuar modelet e duhura”.

“Këtu janë edhe disa drejtuesve vendor dhe shpresoj shumë që nga kjo bisedë e sotme të çelim një kapitull të ri bashkëpunimi dhe ndërveprimi me territoret në të cilat zhvillohet jeta e përditshme e fshatit”, tha Rama.

## Denaj: Kantina e verës në Berat priti 20 mijë turistë në 5 muaj

Kantinat e verës janë tashmë vlerë e shtuar në ofertën turistike, duke u kthyer në destinacione të preferuara për turistët e huaj.

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Anila Denaj, ndau në rrjete sociale historinë e Admirit, që tregon se ky vit ka qenë shumë i mbarë, me një rritje të ndjeshme të numrit të turistëve.

Denaj tha se, vetëm në gjysmën e parë të vitit, kantina është vizituar nga 20,000 turistë, duke e kthyer përvojën shqiptare të verës në një destinacion të preferuar për vizitorët e huaj.

“Etiketat shqiptare po fitojnë gjithnjë e më shumë vëmendje ndërkombëtare, duke e bërë verën “Made in Albania” një zgjedhje të parë për të gjithë ata që kërkojnë cilësi, shije dhe autenticitet”, u shpreh ministria.

Ndërsa Admiri tregoi se, në kantinë prodhohen vera të cilësisë së lartë që janë testuar nga ekspertët të huaj francez e austriakë.

“Në kantinën tonë ne u ofrojmë vizitorëve shëtitje në

vreshta, degustim të verës, teksa vihet re një interes i shtuar i tyre për varietetet autoktone të rrushit në rajonin tonë”, tha Admiri, teksa vuri në dukje se vera e prodhuar me varietetin autokton të rrushit puls, është ndër më të kërkuarat nga turistët e huaj.

Njëri nga turistët e huaj gjatë

vizitës në vreshta, u shpreh se ky është një vend shumë i bukur për tu parë dhe siç tha ai, “Unë jam shumë i interesuar për verërat dhe nuk e kam parë kurrë këtë. Nuk jam profesionist por është shumë kënaqësi ta shohësh dhe shijosh rrushin në vreshta”.



## Pensionistëve “u gjendet punë” në bujqësi! - Nëse aplikojnë për subvencione, do të jenë automatikisht përfitues

Të moshuratisht do të nxiten që të jenë aktiv gjatë periudhës së pensionit duke punuar në bujqësi dhe blegtori.

Në dokumentin e planit të moshimit 2025-2030 të miratuar nga qeveria, synohet të ofrohen mundësi për individët e

duke përfshirë edhe përfituesit e moshës së tretë të ndarë sipas gjinisë burra e gra. Përmes politikave të diskriminimit pozitiv, 100% e aplikantëve të moshuar do të jenë përfitues nga grantet e AZHBR.

Kjo vlen për të gjithë të mosh-

me punët e shtëpisë, duke qenë pronarë me burrat, nëpërmjet lehtësirave të formularëve të aplikimit dhe një diskriminimi pozitiv, mund të mbështetjet për të përfituar nga grantet e Agjencisë së Zhvillimit Bujqësor dhe Rural (AZHBR).

Rehabilitimi i hapësirave të gjelbërta është një tjetër mundësi për punësimin në sektorin e gjelbër. Kjo politikë synohet të zhvillohet në nivele të pushtetit lokal, duke vënë në dispozicion hapësira publike në pronësi të bashkive, për të nxitur zhvillimin e kopështarisë.

Minimalisht 50% e bashkive duhet të përfshijnë në planet sociale lokale aktivitetin e të moshuarve në rehabilitimin e hapësirave të gjelbërta në pronësi të tyre.

Rezultatet e pritshme nga këto politika, janë krijimi i mundësive të punësimit për individët e moshës së tretë, aktivizimi në punët vullnetare, që ndihmojnë jetesën aktive të tyre dhe përfshirjen në shoqëri, si dhe rritjen e të ardhurave.



moshës së tretë që të angazhohen në aktivitete të gjelbërta; si bujqësia e qëndrueshme, fermat, blegtorja etj.

Konkretisht planifikohet përmirësimi i kriterëve dhe formularit të aplikimit për marrjen e granteve nga AZHBR

uarit e zonave rurale, që në pjesën më të madhe hyjnë në kategorinë e të moshuarve të vetmuar, por që aktualisht kanë aftësi fizike dhe mendore dhe janë aktivë.

Në mënyrë të veçantë gratë e moshuara në zonat rurale, të cilat merren me bagëtitë apo

## PËRDORNI CERTIFIKIMIN DHE TRAJNIMET PËR TË PROMOVUAR PRODUKTET TUAJA NË TREGJET NDËRKOMBËTARE

## NJË UDHËZUES PRAKTIK PËR EKSPORTUES, GRUMBULLUES DHE ORGANIZATA QË DUAN TË SHFRYTËZOJNË CERTIFIKATAT DHE PËRVOJAT E TRAJNIMIT PËR TË NDËRTUAR BESIM DHE PËR TË HYRË NË TREGJE TË REJA ME KËRKESA TË LARTA

Organizata e Kombeve të Bashkuara për Zhvillim Industrial (UNIDO), përmes Programit Global për Cilësi dhe Standarde (GQSP), të mbështetur nga Qeveria Zvicerane përmes Sekretariatit Shtetëror për Çështjet Ekonomike (SECO), po mbështet fermerët dhe ndërmarrjet e vogla e të mesme (NVM) në përmbushjen e standardeve të kërkuara, duke lehtësuar aksesin e tyre në tregjet evropiane dhe ndërkombëtare

Ky udhëzues praktik u drejtohet eksportuesve, grumbulluesve, shoqatave të fermerëve, grupeve lokale (LAG) dhe organizatave si ATTC, etj., që duan të shfrytëzojnë rezultatet e certifikimeve (p.sh. GLOBALG.A.P., organike, FairWild) dhe trajnimeve (GAP, gjurmueshmëri) për të hyrë në tregje të reja dhe për të krijuar besim te blerësit ndërkombëtarë.

ose dosje kompanie gjithëpërfshirëse. Ajo mund të përfshijë:

- **Informacioni i përgjithshëm:** Emri i kompanisë/shoqatës; produktet që ofroni; zonat e mbledhjes/kultivimit.
- **Fermerët dhe certifikatat:** Numri i fermerëve të certifikuar dhe llojet e certifikatave (p.sh. GLOBALG.A.P., organike, FairWild). Kjo tregon përmasën e organizimit tuaj.
- **Dokumentet e trajnimeve:** Emrat e trajnimeve të ndjekura dhe institucionet partnere (p.sh. ATTC, GIZ, GQSP).

• **Fotografi ilustrative:** Foto nga fushat, grumbullimi, tharja dhe paketimi e produkteve. Përdorni këto vizualizime për t'i bërë historitë tuaja më të prekshme.

• **Linqe B2B:** Profilët në platforma tregtare (p.sh. CBI, Access2Markets), ku të paraqiteni si furnizues me certifikata.

### Përfshini kopje të mëposhtme:

• **Certifikatat:** Fotografoni ose skanoni certifikatat (p.sh. organike, GLOBALG.A.P.) dhe bashkëngjitini dokumenteve tuaja.

• **Certifikatat e trajnimit:** Kartela ose certifikata të pjesëmarrjes në kurse, me logot e organizatorëve.

• **Raportet laboratorike:** Analizat kimike (pesticide, kripërat e rëndë, mikrobe) në format PDF. Certifikatat e analizës (COA) janë të nevojshme si provë cilësie.

Kjo dosje teknike e detajuar tregon se jeni profesionist dhe i gatshëm të jepni informacion gjithëpërfshirës për cilësinë dhe sigurinë e produkteve tuaja.

### 3. Ku t'i promovoni këto materiale?

Materialet e përgatitura mund t'i shpërndani përmes kanaleve kryesore të marketingut të eksportit:

• **Panairë ndërkombëtare:** Ndërtojeni dosjet e shtypura dhe kthetrat produktit për panairin. Përdorni edhe katalogë digjitalë (USB ose kode QR) që të kenë qasje të menjëhershme tek certifikatat tuaja. Sigurohuni që **materialet promionale të jenë të përditësuara**, me versionet më të fundit të certifikatave dhe analizave.

• **Email prezantimi:** Kur kontaktoni blerës potencialë me email, bashkëngjitni PDF-në e profilit/treguesit dhe foto produktesh cilësore. Përmendni linket drejt certifikatave kryesore ose analizave laboratorike në email.

• **Platforma B2B (p.sh. CBI, Access2Markets):** Plotësoni profilin e kompanisë me informacion për trajnime dhe certifikime. Përditësoni rregullisht të dhënat në këto platformat, pasi blerësit e përdorin për të kërkuar furnizues me standarde të larta.

• **Rrjetet sociale profesionale (LinkedIn):** Ndani foto nga auditimet, momentet e trajnimeve, ose kopertina certifikatash për të treguar aktivitetin tuaj. Ju mund të postoni edhe histori suksesi të fermerëve të certifikuar. Kjo i bën çështjet teknike më të aksesueshme për blerësit.

• **Webfaqja e kompanisë:** Krijoni një faqe të posaçme ku tregohen certifikatat, standardet dhe praktikat tuaja të qëndrueshme. Shfaqni "trust badges" – emblema ose logo certifikatesh nga organizata të njohura – për të forcuar besueshmërinë. Certifikata e gjurmueshmërisë apo logoja e GLOBALG.A.P. në uebfaqe sinjalizojnë angazhimin tuaj ndaj cilësisë dhe transparencës.

### 4. Shembuj konkretë të përdorimit në marketing

• **Në dokumentet e produkteve:** Shtoni pasazhe si: "Kjo ngarkesë është mbledhur dhe përpunuar nga një grup prej 22 fermerësh të certifikuar me GLOBALG.A.P., ku trajnimet GAP janë realizuar në bashkëpunim me ATTC dhe GQSP Albania." Ky paragraf i shkruar në dosjen e produktit nënvizon angazhimin ndaj standardeve ndërkombëtare.

• **Në email prezantues:** Për shembull, dërgoni: "Attached please find our product catalogue along with our updated Organic certificate and pesticide analysis (March 2025). We recently completed a post-harvest training organized by ATTC." (Shënim: "pesticide analysis" përkthehet si raport analizash laboratorike). Kjo tregon kujdes ndaj sigurisë ushqimore dhe angazhimit për përmirësim.

### 5. Këshilla për prezantim me ndikim

• **Gjuhë të thjeshtë, profesionale:** Përdorni termat teknike kryesore (p.sh. "certifikatë organike", "GLOBALG.A.P."), por shpjegoni shkurt në gjuhën e blerësit (zakonisht anglisht).

• **Të konkretë:** Jepni shifra dhe fakte konkrete – sa fermerë, sa hectare ose tonelata prodhim, cilat certifikata posedoni. Theksoni numrin e marrëveshjeve apo bashkëpunimeve të realizuara në kuadër të trajnimeve.

• **Logo të organizatave:** Përdorni logot e institucioneve mbështetëse (p.sh. GIZ, ATTC, CBI etj.) si "trust badges" në materialet tuaja. Të dhënat tregojnë që prezantimi i emblema të tilla nga palë të treta i jep besueshmëri dhe siguron blerësit se ju ndiqni standarde të larta.

• **Vizualizime dhe storytelling:** Ilustroni të dhënat tuaja me foto dhe histori nga ferma. Konsumatorët dhe blerësit preferojnë produkte të gjurmueshme me histori pozitive. Për shembull, tregoni rrëfimin e një grupi fermerësh malor të certifikuar – si e rritën produktin, si u trajnuan, dhe çfarë dobi solli certifikimi për komunitetin.

### 6. Mos i lini certifikatat në sirtar

Certifikatat, analizat dhe trajnimet janë asete tregu – jo thjesht dokumente për inspektorët. Një studim i fundit vë në pah se furnizuesit e certifikuar prioritetizohen nga blerësit dhe renditen më lart në listat e furnizuesve potencialë. **Investimi në certifikim** tregon angazhimin ndaj cilësisë dhe përmirësimit të vazhdueshëm, duke hapur rrugën për tregje premium me kërkesa të larta. Përdoreni këtë avantazh për të:

• Të fituar **blerës të rinj** (duke qenë në krye të listave dhe me reputacion më të lartë).

• Të hapur dyert e **tregjeve premium** (ku blerësit paguajnë çmime më të larta për cilësi të certifikuar).

• Të pozicionuar si **furnizues me standarde të larta**, duke rritur besimin e blerësve ekzistues dhe të ardhshëm.

### Shembull suksesi

Një rast konkret – për ilustrim – vjen nga panairi organik Biofach. Një eksportues nga Dibra përgatiti një profil 3-faqesh, ku përfshiu informacion mbi fermerët e certifikuar, certifikatat ekzistuese, trajnimin e bërë me ATTC dhe rezultatet laboratorike. Ai e shpërndau këtë profil në Biofach (panairi më i madh organik në botë), dhe mori **dy kontrata testuese** me importues holandezë. Ky shembull tregon se përdorimi strategjik i certifikatave dhe trajnimeve mund të përkthehet direkt në mundësi të reja biznesi.

### 1. Çfarë kërkojnë blerësit ndërkombëtarë?

Blerësit ndërkombëtarë duan **cilësi të lartë dhe të qëndrueshme**, që vërtetohet nga certifikatat përkatëse. Ata kërkojnë **garanci për praktika të qëndrueshme dhe zinxhirë furnizimi të gjurmueshëm** – d.m.th. dokumentim të plotë të secilit hap të prodhimit që tregon se produkti është rritur dhe përpunuar sipas rregullave. Çdo histori suksesi prodhimi (certifikime organike, FairWild etj.) dhe çdo përmirësim i vazhdueshëm i cilësisë rrit besueshmërinë. Pra, nëse keni certifikime si GLOBALG.A.P., organike, FairWild apo keni ndjekur trajnime të standardeve GAP dhe gjurmueshmërisë, duhet ta komunikoni këtë me strategji.

• **Cilësi të certifikuar:** Blerësit shpesh kërkojnë certifikime si GLOBALG.A.P. dhe respektim të standardeve të tjera mjedisore dhe sociale.

• **Praktika të gjurmueshme:** Ata presin që zinxhiri juaj furnizues të jetë transparent – çdo hap i prodhimit nga ferma në ambalazh duhet të dokumentohet. Kjo përfshin gjurmueshmërinë e barërave, plehrave, dhe proceset e tharjes/paketimit.

• **Dokumentim i trajnimeve/auditimeve:** Blerësit pyesin për historikun tuaj të trajnimeve dhe auditimeve. Tregoni çfarë kurseve (p.sh. GACP, GAP, trajnim post-zhurmë) dhe auditimesh keni kaluar, sepse kjo tregon angazhim për përmirësim të vazhdueshëm.

• **Transparencë dhe komunikim i qartë:** Blerësit duan partnerë që mund të japin informacion të verifikueshëm. Sigurohuni që **të keni dokumentacion të plotë** dhe të shpjegoni çfarë ka arritur biznesi juaj. Certifikatat funksionojnë si "peze në letër" për këto premtime.

**Këshilla:** Përmendni me strategji sukseset tuaja të certifikimit dhe trajnimit. Për shembull, theksoni se "ky grup është certifikuar GLOBALG.A.P. dhe ka ndjekur trajnime GAP me mbështetje të projekteve vendore" për të rritur besueshmërinë tek blerësi.

### 2. Si të dokumentoni dhe promovoni rezultatet e certifikimit dhe trajnimeve?

Për të vërtetuar këto arritje, krijoni një "Profil Furnizuesi"

## TEMA TË DITËS

# Rama: Së shpejti, fushatë informimi për zbatimin e “Paketës së Maleve”

Kryeministri Edi Rama tha se sa i takon zbatimit të “Paketës së Maleve” shumë shpejt do të ketë një bashkëbisedim

ndjekësve të tij në rrjetet sociale tha se zhvillimi rural dhe fshatit në tërësi është në fokus të mandatit të katërt të qever-

zinxhirin e aplikimit”, tha Rama.

“Ashtu siç edhe e kemi lënë të analizojmë një ditë intensive bashkëbisedimi me një grup protagonistët të zhvillimit rural, grumbullues, agropërpunues, eksportues, po ashtu edhe akademik për të patur një proces dëgjimi të kujdesshëm të ideve, sugjerimeve, vërejtjeve, opinioneve të tyre, në mënyrë që projektin që kemi në mandatin e katërt për bujqësinë, zhvillimin rural dhe fshatin, në mënyrë që të marrim në konsideratë aspekte reale që vijnë si drejtpërdrejt si nevojat të njerëzve të tokës. Po aty do të kemi një pikë të diskutimit që do të lidhet edhe me zhvillimin e mëtejshëm të agroturizmit, pjesë e të cilës do të jetë dhe paketa e maleve”, tha Rama.



me agropërpunues, eksportues dhe protagonist të zhvillimit rural.

Rama, gjatë rubrikës “Sym’sy”, duke i’u përgjigjur

isë.

“Faktikisht kemi folur jo më larg se dje në kabinet për një fushatë promovimi dhe informimi të saktë për të gjithë

## Alberti: Synojmë të sjellim kompani të mëdha të operojnë në Shqipëri, thellojmë praninë strategjike italiane

Ambasadori i Italisë në Shqipëri, Marco Alberti, deklaroi në një intervistë televizive në emisionin “Realitete shqiptaro – italiane”, në Radio Televizionin Shqiptar u shpreh se marrëdhëniet mes dy vendeve kanë një potencial të madh që ende nuk janë shfrytëzuar plotësisht.

Alberti theksoi angazhimin për thellimin e bashkëpunimit ekonomik dhe kulturor mes Italisë dhe Shqipërisë. Ai nënvizoi se do të vazhdojnë të mbështesin bizneset e vogla dhe të mesme që tashmë operojnë në vend, ndërsa theksoi se një ndër objektivat është të sjellë kompani të mëdha të investojnë në vendin tonë.

“Potenciali i marrëdhënieve Itali-Shqipëri është i madh, ka pjesë të këtij potenciali që nuk janë shfrytëzuar dhe unë jam përqendruar në to. Një ndër objektivat është të sjellim kompani të mëdha. Janë rreth 3000 ndërmarrje italiane që operojnë këtu, do të vazhdojmë të mbështesim ndërmarrje të vogla e të mesme, do të donim edhe ndërmarrje të mëdha për të hapur më shumë vende pune për të thelluar e forcuar praninë strategjike italiane në vend. Unë besoj se janë gjasat për të, pala shqiptarë është shprehur në favor. Italia ka besim tek Shqipëria”, tha Alberti.

Ambasadori gjithashtu vlerësoi marrëdhëniet mes dy popujve, duke përmendur se shumë italianë jetojnë në Shqipëri, ndërsa shqiptarët

janë ndër komunitetet më të integruara në Itali.

“Sipas regjistrimit vjetor në IRE janë rreth 3000 persona, por besoj se janë të paktën 10 herë më shumë ata që qëndrojnë këtu jo për pe-

ma nëpërmjet të cilës është e mundur të gjenerohen edhe forma të biznesit, forma të fitimit. Ajo që duam të bëjmë është të gjejmë rrugë dhe mënyra që ndihmojnë bizneset të kenë edhe një



riudha shumë të gjata. Është një e dhënë e rëndësishme që tregon se italianët ndihen mirë këtu, si në shtëpinë e tyre. Shqiptarët janë më të integruar në Itali dhe në rend numerik zënë vendin e dytë ndër komunitete e huaja të pranishme në Itali. Integrimi i shqiptarëve në Itali është një fakt pozitiv dhe shpresë dhënë dhe e anasjelltë, pasi italianët këtu ndihen shumë mire”, tha Alberti.

Duke folur për rëndësinë e kulturës, Alberti theksoi se ajo duhet të shihet edhe si një platformë për zhvillimin ekonomik.

“Binomi është kulturë dhe biznes. Kultura është platfor-

vizion kulturor”, tha ai.

I pyetur për aktualitetin politik në vend, ambasadori përmendi pjesëmarrjen gjithëpërfshirëse në aktivitetet e ambasadës.

“Ishin edhe përfaqësues të opozitës në festën e Republikës, ideja jonë nuk është të punojmë vetëm me institucionet e qeverisë ka një hapje të ambasadës ndaj të gjithëve. Populli shqiptar votoi, zgjodhi. Do të fillojë etapë e re e historisë së Shqipërisë, ne do të shohim dhe do të bashkëpunojmë me të gjithë që janë të gatshëm të bashkëpunojnë me ne”, u shpreh Alberti.

# Ministria e Bujqësisë: 4 vatra të murtajës me 716 bagëti të prekura, ndalohe tregtimi në tregjet e kafshëve të gjalla

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural bëri të ditur se deri tani raportohen 4 vatra të murtajës në vend, ku janë prekur në total 716 të imta.

Në një raportim mbi situatën

km) dhe të mbikëqyrjes (10 km). Në Urdhrat e Ministrit është përcaktuar qartë, që për çdo rast të konfirmuar me këtë sëmundje, marrja e masave të kufizimit të lëvizjes së kafshëve të gjalla”,



e murtajës në vend dhe planin e masave të marra, MBZHR raporton se kanë ngordhur 25 krerë dhe janë eliminuar 153 krerë të imta, proces që vazhdon.

MBZHR e konsideron murtajën e ruminantëve të vegjël (PPR), një sëmundje serioze virale, tepër ngjitëse, e cila ka ngordhshmëri të lartë deri në nivele të 100% të tufës, duke shkaktuar humbje ekonomike, por nuk cenon shëndetin dhe nuk transmetohet te njeriu.

“Konfirmimi i parë për sëmundjen në Shqipëri është bërë më 4 qershor 2025, me vendndodhje në fshatin Domen, njësi administrative Postribë, Bashkia Shkodër. Në vijim, rasti i dytë është konfirmuar më 5 qershor në fshatin Vrenjt, njësi administrative Kastriot, Bashkia Dibër; rasti i tretë më 9 qershor në fshatin Val, njësi administrative Martanesh, Bashkia Bulqizë; dhe rasti i katërt më 11 qershor në fshatin Polenë, njësi administrative Qendër, Bashkia Skrapar. Numri total i vatrave (tufave) të raportuara deri më sot është 4. Numri i të imtave të prekura është 716; të ngordhur, 25 krerë; të eliminuar, 153 krerë; ndërsa krerët e tjerë janë në proces eliminimi”, njofton MBZHR.

Ministria e Bujqësisë siguron se janë ndërmarrë menjëherë masat e nevojshme për parandalimin dhe kontrollin e përhapjes së sëmundjes në territorin e Shqipërisë.

“Janë identifikuar Njësitë Administrative dhe fshatrat brenda zonave të mbrojtjes (3

thuhet në njoftim.

Po ashtu, nisur nga situata shqetësuese dhe përhapja në disa vatra e sëmundjes, prej datës 9 qershor ka hyrë në fuqi urdhri i ministrit për ndalimin e përkohshëm të lëvizjes së dhenve dhe dhive të gjalla në territorin e Shqipërisë.

MBZHR njofton se ndalohe përkohësisht tregtimi i kafshëve të llojit dhen dhe dhi në tregjet e kafshëve të gjalla, mjedise të hapura, panairë dhe grumbullime të tjera. “Është e lejuar vetëm lëvizja e të imtave vetëm për në thertore, e shoqëruar me certifikatë shëndetësore veterinarë, të lëshuar nga veterineri zyrtar i shërbimit. Kjo masë ka karakter të përkohshëm dhe është ndërmarrë në funksion të mbrojtjes së shëndetit të kafshëve, sigurisë ushqimore dhe interesit të blektorëve në vend”, thuhet në njoftim.

Në kuadër të masave të marra, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve ka ngritur 39 grupe kontrolli, duke monitoruar deri më sot 983 ferma të imtash, me një total 164.803 krerësh dhen dhe dhi në rang vendi.

“Qëllimi kryesor i grupeve të kontrollit në terren është monitorimi i fermave të vogla blektorale, evidentimi i situatës epidemiologjike në terren dhe përkaktimi i fazës aktuale të sëmundjes, si bazë për ndërhyrje të mëtejshme, të orientuara dhe efektive. Gjatë monitorimit, grupet e kontrollit kanë kryer rritjen e ndërgjegjësimin të fermer-

ëve për rrezikun ekonomik që paraqet kjo sëmundje”, vijon njoftimi.

MBZHR njofton po ashtu se prania e sëmundjes së murtajës është njoftuar rast pas rasti në Sistemin e Njoftimit të Menjëhershëm të Sëmundjeve të kafshëve të Bashkimit Evropian (ADIS), dhe është kontaktuar edhe Zyra e Emergjencave për Sëmundjet e Kafshëve pranë Komisionit Evropian, e cila ka shprehur gatishmërinë ndaj kërkesës së MBZHR-së për të dërguar në Shqipëri një mision teknik.

“Ditën e sotme dhe nesër po organizohet një takim në ambientet e Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, me pjesëmarrjen e dy ekspertëve të Komisionit Evropian, përfaqësuesve të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, AKVMB-së, ISUV-it dhe Urdhrit Profesional të Mjekut Veterinar të Shqipërisë. Po sot, këta përfaqësues do të kryejnë një vizitë në terren, në një nga vatrave ku është konfirmuar prania e sëmundjes. Në përfundim të vizitës, Misioni Teknik EU-VET i Komisionit Evropian do të japë rekomandime në lidhje me menaxhimin e situatës dhe strategjitë e kontrollit të pranisë së sëmundjes së Murtajës së Ruminantëve të Vegjël (PPR)”, vijon njoftimi.

Kjo përgjigje e shpejtë dhe e koordinuar me DG SANTE ndaj rastit të parë të PPR në vendin tonë, sipas MBZHR, “është një tregues i përkushtimit të Shqipërisë për të respektuar standardet evropiane në fushën e shëndetit dhe sigurisë veterinarë”.

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural i bën thirrje të gjithë fermerëve të zbatojnë me përpikëri masat e biosigurisë në fermat e tyre dhe të shmangin çdo lëvizje të kafshëve jashtë fermës, duke zbatuar rregullat në fuqi dhe duke bashkëpunuar për një të mire të përbashkët: ekonominë blektorale në vend.

Po ashtu, MBZHR apelon ndaj të gjithë fermerëve dhe aktorëve të përfshirë në sektorin blegtoral që, për çdo rast të evidentimit të shenjave të dyshimta apo ngordhjeve në të imta, të kontaktojnë menjëherë në numrin e gjelbër 08003366.

## Skema Kombëtare e Investimeve, fermeri nga Peqini shtoi mekanikën bujqësore

Arian Karina në fshatin Gjoçaj, Peqin prej 9 vitesh kultivon pemëtari në 2 hektarë tokë, me fokus tek prodhimi i nektarinave, pjeshkëve, ullinjve dhe kajsive.

Prodhimi i tij shkon si në tregun vendas, ashtu edhe në eksport duke kontribuar në zhvillimin e ekonomisë familjare dhe zonës përreth.

Si përfitues i Skemës Kom-

bëtare të Investimeve, Ariani ka marrë mbështetje financiare nga Agjencia për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural për blerjen e një traktori dhe pajisjeve ndihmëse, që kanë përmirësuar ndjeshëm proceset e punës në fermë.

AZHBR ndau në rrjetet sociale historinë e tij, ndërsa vetë Ariani tregon se, procesi i aplikimit pranë AZHBR ishte i

thjeshtë dhe i shpejtë dhe brenda një kohe të shkurtër u shpall fitues, lidhi kontratën dhe bleu traktorin dhe agregatët për punë të mekanizuar në fermë.

AZHBR thekson se, mbështetja përmes Skemës Kombëtare po kontribuon në modernizimin e fermës, duke lehtësuar dhe përshpejtuar punën me mekanikën bujqësore.

Në periudhën Maj-Qershor 2025, projekti i ITC (International Trade Centre - <https://www.intracen.org/>) në Shqipëri zhvilloi një **program të plotë trajnimi dhe asistencë teknike për 10 SME eksportuese të vajit të ullirit**, me fokus në përmirësimin e cilësisë së produktit dhe përgatitjen për tregjet ndërkombëtare.

**Takimet dhe trajnimet janë përqendruar në këto çështje kryesore:**

- Prezantimi i **standardeve të Bashkimit European** për cilësinë, pastërtinë dhe siguri-

në e vajit të ullirit, duke përfshirë parametrat analitikë si aciditeti, numri i peroksive, polifenolët, dhe mbetjet e pesticideve.

- **Analiza laboratorike** e kampioneve të vajit nga secila kompani, të realizuara si brenda vendit, ashtu edhe në labo-

ratore të certifikuara ndërkombëtare në Itali.

- **Zbatimi i metodave të mbrojtjes biologjike** ndaj dëmtesave në ullishtet shqiptare, me theks në përdorimin e kaolinit si alternativë natyrale.

- Organizimi i **demonstri-**

**meve praktike në terren dhe konsultimeve me çdo SME**, ku u dhanë rekomandime të drejtpërdrejta për përmirësimin e praktikave të kultivimit dhe përpunimit organik.

Ky aktivitet shërbeu gjithashtu si një **platformë shkëmbimi mes aktorëve të**

**sektorit**, duke përfshirë përfaqësues të organizatave të sektorit (KASH dhe AOA), Universitetit të Tiranës - Fakultetit të Bujqësisë dhe aktoreve të tjere të sektorit. Diskutimet u përqendruan në sfidat aktuale, mundësitë për certifikim dhe përmbushjen e standardeve të


BE-së në funksion të rritjes së eksporteve.

**Në vijim, ITC parashikon:**

- Mbështetje për **certifikimin e SME-ve** për tregje të huaja, në bashkëpunim me institucione kombëtare dhe ndërkombëtare;

- Zgjerimin e aktiviteteve të ngjashme në sektorin e **bimëve mjekësore dhe aromatike**;

- Promovimin e pjesëmarrjes së kompanive shqiptare në **panaireset e ardhshme ndërkombëtare** si Food Ingredients USA 2025 dhe Gulfood 2026



## Ngadalësohet inflacioni në maj/ Më shtrenjtë vijojmë të paguajmë për ushqimet. Restorantet dhe argëtimin

*Për ushqime, bare e restorante si dhe argëtim*

Shqiptarët paguajtën më shtrenjtë në maj. Rritja e çmimeve e ndikuar nga këto grup-kategori ndikuan në inflacion me 2.2% në muajin që lamë pas.

Inflacioni tek ushqimet arriti në 1.11%. I ndikuar kryesisht nga konsumi i lartë i zarzavateve. Pavarësisht se në treg mbizotëron tashmë prodhimi vendas dhe konsumi është rritur, çmimet ende qëndrojnë të larta.

Ndikuar edhe nga turizmi qiratë lëndët djegëse u shtrenjtuan me 0.3%, pije alkoolike dhe argëtim me përkatësisht 0.18% dhe 0.14% ndërsa më të shtrenjta çmimet janë edhe tek baret e restorantet.

Ndonëse vlerat e inflacionit në maj në Europë ranë, në Shqipëri ky përkthim i shifrave ende nuk po ndihet.

Inflacioni deri në fund të vitet pritet të arrijë në objektivin

prej 3%. Por tendencat në rritje të mëtejshme mund të ndry-

shojnë nga presionet e jashtme sipas ekspertëve të tregut.



## Prodhimet blegtorale, rriten ndjeshëm çmimet në treg për produktet e bulmetit dhe të mishit

*Shqiptarëve produktet me origjinë shtazore po u kushtojnë gjithnjë e më tepër*

Nëse bëjmë një krahasim të çmimeve të bulmetit nga viti 2013 e deri më tani, një kilogram djathë lope kushton 133% më tepër, djathi i deles 136% më

Të mbarështosh gjë të gjallë në Shqipëri është e mundimshme dhe aspak fitimprurëse, në mungesë të produkti vendas industria e përpunimit

madhe të çmimit përgjatë këtij dhjetëvjeçari, duke shkuar 128% më shumë.

*“Mishi në 2013 ka qenë me 700 lekë/kg , tani ka arritur 1100-1200. Mishi I gicit dikur kushtonte 350 lekë/kg, por sot kushton 800 lekë kg”*, shton më tej tregtari.

Tregtarë e qytetarë, të gjithë janë në kërkim të shijes shqiptare, por për ta siguruar këtë është tepër e vështirë.

*“Ne mendohe mi që t’i gjejmë të gjithë këtu produktet por është shumë e vështirë. Imagjino në një fshat mund të gesh vetëm një viç”*, përfundoi Artan Hazizaj, tregtar.

Nëse i referohemi të dhënave nga INSTAT në këtë 10 vjeçar të fundit numri I lopëve, deleve dhe dhive është përgjysmuar.

Në vitin 2013 kishim mijë gjedhë, ndërsa në 2013 263 mijë. Të imta në 2013 kishim 2.725.000 nga 1.846.000 që janë regjistruar në 2023.



shumë, kurse gjalpi i freskët ka pësuar 100% rritje të çmimit.

*“Në vitin 2013 djathin e lopës e gjenim me 300 lekë/kg, ndërsa sot kushton 700 lekë/kg. Djathi i deles ka qenë 550lekë/kg ndërsa sot kushton 1200-1300 lekë/kg. Djathi i freskët ka qenë 500 lekë/kg, tani kushton 1100 lekë/kg”*, shprehet Artan Hazizaj, tregtar.

të qumështit dhe bizneset e mishit furnizohen me produkte importi. Nëse qumështi vjen nga Serbia, mishi ka si origjinë nga Rumaninë dhe Bullgarinë. E gjithë kjo ka bërë që një kg mishi viçi për konsumatorin vendas të kushtojë 71% më tepër. Edhe pse mishi i derrit vazhdon të jetë më i liri në treg, ai ka pësuar ndryshimin më të





## BKFSH

**BASHKIMI KOMBËTAR I FERMERËVE SHQIPTARË**  
Adresa: Rr. "Mine Peza", Pall. 87/3, Hyrja 1, Kati 1, Tiranë, Albania  
Tel/Fax: ++355 4 259195, E-mail: bkfs@abmc.org.al

# Të luftojmë "tre armiqtë" e fermerit

*Fermeri është e vetmja shtresë që ka shumë nevojë për ndihmë. Meqë veprimtaria e fermerit është në natyrë, atë e rrezikojnë shumë probleme në mes tyre vetë Natyra. Ndër tre armiqtë kryesorë janë: 1. Moskullimi i tokës, 2. Thatësira, 3. Erozioni dhe përmytja*

Bashkimi Kombëtar i Fermerëve të Shqipërisë (BKFSH) duke vlerësuar rrezikun e këtyre tre armiqtë të fermerit ka tetë vjet që nga viti 2017 që i ka propozuar Kryeministrit që periudha nga qershori e deri në muajin dhjetor sa të lejojnë kushtet, të bëhet aksion për kullimin e tokës, vaditjen, erozionin dhe përmytjen.

Mendojmë se ky aksion i siguron fermerit një tokë të përgatitur nga këto rreziqe. Kjo është për çdo fermer që disponon tokën si nënë e të gjithë gjallesave, nga bima që e rrit, e deri nga prodhimi që merr. Pra është një nënë e gjithë njerëzimit.

BKFSH e ka ndjekur këtë aksion çdo vit, duke bashkëpunuar me organet e pushtetit lokal dhe me Drejtoritë e Bujqësisë, duke koordinuar punën me këto drejtues si dhe me bordet e kullimit. Nga ana e BKFSH janë caktuar anëtarët e këshillit për çdo qark, të cilët koordinojnë me to problemet e këtij aksioni. Si rezultat ka patur ecuri të mirë, por kërkohet me shumë ndjenjë përgjegjësie nga drejtuesit e bashkive dhe mundësisht deri tek qeveria. Rezultate ka patur me shumë deri në vitin 2018. Pati pengesa në vitin 2019 dhe 2020 nga tërmeti dhe pandemia. Këshilli i BKFSH në vitin 2022 u bëri letër kryetarëve të 34 bashkive, për t'i kërkuar ndihmë për problemet e këtij aksioni të rëndësishëm. Kjo letër ndihmoi shumë dhe pati vlerësime nga shumë kryetare bashkish, si Pjerin Ndreu, kryetar i Bashkisë Lezhë, zv/kryetarja e Bashkisë Vlorë, Aulona Gashi, Bashkia e Pogradecit, Bashkia Dimal i Beratit kryesisht Fatime Plaku, si drejtuese e bujqësisë së kësaj Bashkie.

### • PËR KULLIMIN:

Kullimi i tokës është tepër i domosdoshëm për fermerin

pasi rregullon strukturën e tokës, largon lagështirën e panevojshme, siguron mbjelljet e hershme, ajrosje të tokës dhe ndihmon pozitivisht për klimën. Kullimi duhet për çdo tokë por veçanërisht për zonat fushore, që përfaqësojnë 280 mijë hektarë dhe duhen kulluar patjetër. Me këtë kullim duhet të lëvizin 8 milion metër kub dhera. Po të llogarisim fuqinë mekanike prej 61 traktorë krahëgjatë të bashkive si dhe ekskavatorët e bordeve të kullimit, kjo sipërfaqe realizohet pa vështirësi, edhe në kohë. Praktikisht në shkallë vendi kanë punuar në aksion mbi 50 ekskavatorë krahëshkurtër e fadroma dhe mbi 20-25 ekskavatorë të bordeve të kullimit, si dhe 15 ekskavatorë të bashkive. Ky problem duhet të zgjidhet duke vënë në punë me shumë ekskavatorë krahëgjatë të bashkive dhe të shtohet numri i ekskavatorëve të vegjël pasi është problem dhe janë pak. Përfshirë bashkitë e mëdha si Tirana, Durrësi, Korça, Fieri, Lushnja që kanë nga 4 ekskavatorë të vegjël dhe Lezha ka 6, që përdoren për kanalet e dyta dhe të treta, bashkitë e tjera kanë vetëm nga 2 deri 3 ekskavatorë. Në këtë gjendje nuk i përballon kullimit.

Më mirë me kullimin kanë punuar Bashkia Lezhë, e cila ka realizuar deri 400 km pastrim kanalesh kullues në vit. Mirë kanë punuar dhe Bashkitë Shkodër, Durrës, Korçë, veçanërisht Bashkia Maliq, Bashkia Dimal i Beratit, Bashkia e Pogradecit, Bashkia e Tiranës, e Fierit, e Lushnjës, e Elbasanit.

Vlen të vlerësohet puna e mirë e bërë nga bordet e kullimit për pastrimin e kanaleve të ujërave të larta dhe kanaleve të para. Punë të mirë kanë bërë për kullimin Bashkia e Tiranës ku aksioni drejtohet nga Vlash Kaçinari, Bashkia e Vorës që drejtohet nga Drejtori i Bu-

jqësisë Islam Dervishi, i cili ka qenë vetë në krye të punës, Bashkia Shijak nën kujdesin e Drejtorit të Bujqësisë Maksim Krucka. Shumë mirë ka punuar Bashkia Dimal ku kryesisht është angazhuar në mënyrë direkte Drejtoresha e Bujqësisë, Fatime Plaku.

Me gjithë punën e bërë përsëri për kullimin ka nevojë për më shumë punë pasi shumë kanale mbeten pa kulluar kryesisht kanalet e ujërave të larta që mbulohen me kallama dhe barishte.

Për kanalet e ujërave të larta shumë mirë ka punuar Bashkia e Durrësit dhe veçanërisht njësia administrative Sukthi i Ri, ku drejton Edi Cerri si kryetar dhe inxhinieri Xhevahir Çausi, që kanë kulluar 6 kilometra në kanalin e Tonës, që mbledh ujërat e gati gjithë Sukthit në anën lindore dhe perëndimore.

Kërkojmë preokupim dhe ndjekje më të mirë për kullimin nga kryetarët e bashkive dhe drejtuesit e bujqësisë në bashki dhe mundësisht dhe nga drejtoritë rajonale të bujqësisë.

### • PËR UJITJEN:

Ujitja lufton armikun që është thatësira. Shqipëria është një ndër shtetet me rezervat më të mëdha ujore, ku disponon 247 liqene të ndryshme me sipërfaqe 1200 km katrorë. Disponon 670 rezervuarë ujëmbledhës dhe 200 burime nëntokësore. Aftësia ujitëse gjatë viteve '90 ka qenë 450 mijë hektarë, ndërsa për fakt të keq sot nuk është as 50% e asaj sasie. Është për të ardhur keq që kanalet ujitëse që kanë qenë ndërtuar në Dibër, në Shkodër, në Mat, Elbasan, Korçë etj. janë dëmtuar dhe nuk është vënë dorë mbi to. Me shumë punë duhet për pastrimin e kanaleve vaditëse, veçanërisht nga rezervuarët deri në parcela për arsye se ky problem nuk është

vlerësuar sa duhet dhe kërkojmë vlerësim të përvitshëm.

Një problem i madh është funksionimi i rezervuarëve për ujitje. Një pjesë e rezervuarëve kanë dëmtime edhe mbushje pa pastruar. Një pjesë janë zënë me peshk. Më mirë kanë punuar Bashkia Tiranë, ku nga 42 rezervuarë janë në punë 36 prej tyre. Bashkia Korçë ku nga 58 rezervuarë punojnë 52. Në Bashkinë e Beratit nga 21 rezervuarë punojnë 21. Bashkia Durrës nga 4 rezervuarë punojnë 3 prej tyre. Bashkia Dimal i Beratit nga 9 rezervuarë, punojnë 8 prej tyre. Përgjithësisht në aksion, nga 162 rezervuarë kanë punuar 146 prej tyre. Shumë problem ka me riparimin e rezervuarëve ku janë dëmtuar edhe bankinat. Mendojmë se rezervuarët duhet të kalojnë nën administrimin e bashkive ku të shoqërohen edhe me investimet përkatëse.

Më shumë kujdes duhet për investimet për shtimin e aftësisë ujitëse, mbasi infrastruktura kullim-ujitje nga viti 1922 ka patur rënie. Në strategjinë e vitit 2017-2027 duhet të investoheshin çdo vit mbi 74 milion dollarë. Për fat të keq kjo sasi është realizuar vetëm 35-40% çdo vit. Më shumë kujdes duhet për investimet për shtimin e aftësisë ujitëse. Për këtë më mirë ka punuar Bashkia e Dibrës me përfaqësues të BKFSH Nazmi Drizi. Bashkia e Shkodrës dhe Lezhës me përfaqësues të BKFSH Zek Deda. Bashkitë Fier dhe Lushnje me përfaqësues Nesti Zoji, dhe në Bashkitë Kavajë dhe Rrogozhinë me përfaqësues Rustem Thartori.

Një problem që duhet zgjidhur është edhe ujitja me anën e stacioneve të pompimit. Më mirë ka punuar Bashkia Tiranë që ka 4 stacione pompimi dhe Bashkia Dimal i Beratit me 2 stacione pompimi. Mundësinë e vaditjes me stacione pompi-

mi e kanë të gjithë bashkitë në të cilët kalojnë lumenjtë pranë tokave.

### • EROZIONI DHE PËRMYTJA

Erozioni i sjell çdo vit humbje tokës duke i rrëmbyer dhjetëra hektarë tokë. Ky problem është më i madh në zonat kodrinore si dhe në zonat e tjera ku lumenjtë prishin drejtimin duke marrë inerte jashtë rregullave. Ky problem duhet ndaluar sa më parë dhe të dënohen fajtorët ligjërisht. Po kështu prerja e pyjeve dhe plepave dhe e bimëve mbajtëse në brigjet e lumenjve, dhe përrenjve malore krijojnë rreziqe për erozion.

Shumë dëme nga përmytja çdo vit vijnë si rezultat i shirave të rrëmbyeshëm dhe hapja pa kriter e digave të rezervuarëve dhe të hidrocentraleve. Ky problem duhet të rregullohet detyrimisht nga organet qeveritare dhe pushteti lokal.

Një problem është edhe mosriparimi i rregullt i hidrovorëve dhe ndërtimi i hidrovorëve të rinj si në Maliq të Korçës etj. Shumë e domosdoshme është ndërtimi i bankinave në lumenjtë kryesorë. Vlen të theksohet puna e mirë që ka bërë Bashkia e Durrësit, nën drejtimin direkt të Kryetares së Bashkisë, Emirjana Sako. Është ndërtuar një bankinë shumë e mirë prej 6.5km duke mbrojtur lumin Erzen në njësinë administrative Sukthi i Ri. Ky ka qenë një veprim shumë i rëndësishëm dhe mjaft dobipurës duke siguruar me mijëra familje dhe shumë sipërfaqe toke nga përmytjet e lumit Erzen. Meritë kanë edhe kryetari i njësies, Edi Cerri dhe inxhinieri Xhevahir Caushi si dhe mjaft kujdes ka treguar kryepalaku i fshtatit Vadardhë Qemal Doda, që ka qëndruar tek koka e ekskavatorit për çdo

problem. Mirënjohës i jemi edhe drejtuesit të ekskavatorit Idajet Olldash, i cili ka kryer një punë të shkëlqyer dhe ka qëndruar më gjatë se ekskavatorët e tjerë duke realizuar një volum mbi 97,500 metër kub dhera dhe sistemuar këto në bankinë.

BKFSH u bën apel të gjithë kryetarëve të bashkive, drejtuesve të bordeve të kullimit, drejtorive rajonale të bujqësisë, Ministrisë së Bujqësisë e deri tek kryetarët e qarqeve dhe deputetët e parlamentit, të ndihmojnë për realizimin me sukses të këtij aksioni me shumë rëndësi për bujqësinë dhe veçanërisht për fermerin hallexhi.

Vlerësojmë punën që kanë bërë kuadrot në bashki dhe përkrahjen nga Ministria e Bujqësisë, veçanërisht Zv.Ministrit Z. Dhimo Kote, që na ka qëndruar pranë duke ndihmuar me bordet e kullimit. Vlerësojmë punën e drejtuesve të bordeve të kullimit për gatishmërinë e tyre dhe cilësinë e punës. Nuk mund të rrimë pa përmendur punën e përfaqësuesve të BKFSH në qarqe si Zek Deda Shkodër, Lezhë, Nazmi Drizi Dibër, Lutfi Lala Elbasan, Rustem Thartori Kavajë, Rrogozhinë, Nesti Zoji Fier, Lushnje, Ilirjan Mezini Vlorë, Fredi Felahu Korçë, Maliq, Devoll, Mond Lole në Berat, të cilët kanë koordinuar dhe zgjidhur problemet, që kanë patur në bashkëpunim me drejtuesit e pushtetit lokal në këtë aksion të rëndësishëm.

Më shumë shpresë presim ndihmë për fermerin shqiptar, që t'i largojmë tre armiqtë e mësipërm dhe mundësisht t'i plotësojmë kërkesat dhe nevojat e tij.


*Me respekt dhe besim,  
Hazis Sava  
Kryetar në detyrë i BKFSH*

## Rama: Bashkitë i kanë mundësitë të krijojnë kompani ndërtimi

Gjatë takimit me kryebashkiakët, kryeministri Rama u shpreh se Bashkitë duhet të disiplinojnë performancën financiare dhe të shtojnë të ardhura, pasi akumulimi i borxheve prej tyre nuk mund të tolerohet më për vitet në vijim.

Si zgjidhje për këtë, kreu i qeverisë hodhi idenë që bashkitë duhet krijojnë kompani ndërtimi në funksion të strehimit, të cilat sipas tij do të krijojnë të ardhura për të mos varen për gjithçka te qeveria qëndrore.

"Ajo që ka shumë rëndësi të nënvizohet është se disiplina financiare e bashkive është sot një domosdoshmëri në të gjithë kontekstin ku jetojmë dhe në kontekstin e asaj që ka të bëjë me thellimin e decentralizimit si përgjegjësi. Dua të ndalem shkurt në disa aspekte. Së pari në aspektin e detyrimeve të prapambetura, siç e kemi diskutuar më parë, ne do të hyjmë në një fazë shtrëngimi pa tol-



erancë, në bazë të parametrave të dakordësuar, jo kot. Dhe

kjo është e nevojshme sepse nuk mundet dot që akumulimi

i borxheve të bëhet një rrugë e hapur dhe për vitet përpara. Kjo është e pamundur. Rritja e performancës së bashkive është një prioritet për ne. Nuk ka si të rriten bashkitë nëse nuk disiplinojnë financat dhe nëse bashkitë nuk mendojnë të shtojnë të ardhurat. Kjo është e dhëna më dramatike që volumi i aktiviteteve që lidhin bashkitë me krijimin e të ardhurave jo buxhetore është minimal, afër zeros.

Është e pamundur që në ende sot, në nivel bashkiak që nga Tirana, nuk kemi asnjë model ekonomik të parvarur. Bashkitë i kanë të gjitha mundësitë të ndërtojnë dhe të krijojnë shanse për njerëzit që kanë nevojë për strehim, por dhe njëkohësisht të fitojnë. Më thoni një kompani bashkiake që ndërton në funksion të strehimit. Nuk ka. Kemi pasur një debat me drejtuesit e Tiranës. Nuk mund të përgjigjet dot qeveria për çdo kërkesë", tha Rama.

## UDHËZUES PËR FERMERËT DHE NVM-TË

### MBLEDHJA E BIMËVE AROMATIKE DHE MJEKËSORE NË SHQIPËRI



#### UDHËZUES PËR FERMERËT DHE NVM-TË MBLEDHJA E BIMËVE AROMATIKE DHE MJEKËSORE NË SHQIPËRI

Duke ndjekur udhëzime e përshkruara në udhëzues, mund të ruani trashëgiminë botanike të vendit ndërsa korrni përfitime ekonomike.

Udhëzuesi ka për qëllim t'i ndihmojë fermerët dhe NVM-të të kuptojnë bazat e mbledhjes së BAM-ve, përfitimet e tyre dhe si të përballen me sfidat e zakonshme.

Mbledhja e qëndrueshme e këtyre bimëve është thelbësore për ruajtjen e biodiversitetit dhe sigurimin e përfitimeve ekonomike afatgjata. Ky udhëzues ofron njohuri praktike për mbledhjen e BAM-ve në mënyrë të përgjegjshme dhe efektive.

## 1 KUADRI LIGJOR DHE RREGULLORET

Në Shqipëri, mbledhja dhe eksporti i bimëve mjekësore dhe aromatike (BMA) janë të rregulluara për të mbrojtur burimet natyrore dhe për të siguruar që praktikë e vjeljes të jenë të qëndrueshme.

### Lejet dhe licencimi

Grumbulluesit duhet të pajisen me leje nga autoritetet lokale për të siguruar që procesi i mbledhjes të monitorohet dhe kontrollohet në mënyrë të ligjshme.

### Speciet e mbrojtura

Disa bimë mbrohen nga ligji për shkak të statusit të tyre të rrezikuar. Është e rëndësishme që mbledhësit të njohin këto lloje për të shmangur pasojat ligjore.

### Praktikat e qëndrueshme

Rregulloret vendosin theksin në metodat e qëndrueshme të vjeljes për të shmangur mbivjeljen dhe për të ruajtur popullatat e bimëve në natyrë.

- **Korja lejohet vetëm në periudha specifike të vitit**, kur bimët janë të pjekura dhe të bollshme, duke siguruar rigjenerimin e tyre.
- Disa zona përcaktohen si të mbrojtura, ku vjelja është e kufizuar ose ndaluar për të ruajtur biodiversitetin dhe habitatet kritike.
- Mbledhësit mund të kërkohen të marrin pjesë në programe për rimbjelljen e zonave të vjela për të garantuar vazhdimësinë e popullatave të bimëve.
- Mbledhësit inkurajohen të vjelin vetëm bimë të pjekura, duke lejuar bimët më të reja të rriten dhe të riprodhohen.
- Komunitetet lokale përfshihen në menaxhimin dhe monitorimin e burimeve bimërore, duke respektuar njohuritë tradicionale.
- Programet e trajnimit për vjelësit përqendrohen në teknikat e qëndrueshme dhe rëndësia e ruajtjes së popullatave të bimëve.
- Zbatohen programe monitorimi dhe lërkimi për të vlerësuar gjendjen e specieve bimërore dhe për të përshtatur praktikën e menaxhimit.
- Promovimi i skemave që çertifikojnë vjeljen e qëndrueshme, duke krijuar përfitime për produkte që vijnë nga praktikë të përgjegjshme.

## 2 PRAKTIKAT E MBLEDHJES SË QËNDRUESHME

Korja e qëndrueshme është thelbësore për ruajtjen e ekosistemit dhe për të siguruar që bimët aromatike dhe mjekësore të mbeten të disponueshme për brezat e ardhshme. Këtu janë disa praktika të mira për mbledhjen e qëndrueshme:



### 1. Identifikimi i saktë i specieve

- Përdorni udhëzues me fotografi dhe ilustrime specifike për rajonin tuaj.
- Shmangni mbledhjen e specieve të mbrojtura ose të gabuara.



### 2. Përdorimi i teknikave që shmangin dëmtimin

- Njohja e biologjisë së bimëve – Studioni ciklin e rritjes dhe rigjenerimit për të vjelur në kohën e duhur.
- Përdorimi i mjeteve të duksura – Krasitëset dhe thikat e mprehta minimizojnë dëmtimin.
- Zgjedhja e bimëve të pjekura – Linë bimët më të reja të rriten dhe riprodhohen.
- Presja mbi rrënjë – Prisni kërcellin disa cm mbi rrënjë për të ndihmuar rigjenerimin.
- Shmangia e mbivjeljes – Mos mbledhni më shumë se 1/3 e popullsisë së bimëve në një zonë.
- Lënia e disa farave – Siguroni rimbjelljen natyrale të bimëve si kopra.
- Korja e qëndrueshme e rrënjëve – Merrni vetëm një pjesë të rrënjës dhe mbilni pjesën tjetër.
- Minimizimi i shqetësimeve të tokës – Shmangni çrënjësien e panevojshme që mund të dëmtojë habitatet.



### 3. Korja në sezonin optimal

- Lavanda – Mbledhet para ose gjatë lulëzimit të hershëm për përmbajtje maksimale të vajit esencial.
- Kamomili – Mbledhet gjatë lulëzimit të plotë për përqendrim maksimal të përbërjeve aktive.



### 4. Mos grumbulloni më shumë se ç'është e nevojshme

- Linë mjaft bimë për rigjenerimin natyral dhe ruajtjen e ekosistemit.

➔ Rezultati: Ruajtja e biodiversitetit dhe sigurimi i burimeve natyrore për të ardhmen.



## 3 VLERËSIMI DHE PRAKTIKAT E MBLEDHJES SË QËNDRUESHME

### Hapat e Korjes së Qëndrueshme

- Vëzhgimi i zonës**  
Analizoni popullsinë e bimëve për të siguruar që është e mjaftueshme për korje pa varrënuar burimet natyrore.
- Vendosja e udhëzimeve për sasinë e korjes**  
Kufizoni korjen në 10-20% të popullsisë së bimëve në një zonë të caktuar.
- Korja vetëm e sasisë së nevojshme**  
Shmangni mbledhjen e tepërt që mund të çojë në mbetje dhe të dëmtojë mjedisin.
- Mbajtja e shënimeve për korjen**  
Regjistroni çfarë, kur dhe sa keni korrur për të monitoruar ndikimin mbi popullatën e bimëve.
- Fokusi në bimët e shëndetshme dhe të pjekura**  
Mbledhni vetëm bimë të pjekura, duke i lënë ato më të reja të rriten.
- Rotacioni i zonave të korjes**  
Jepini bimëve kohë të rikuperohen duke ndërruar vendet e korjes çdo sezon.

➔ Rezultati: Korje e qëndrueshme, ruajtje e biodiversitetit dhe rigjenerim i popullatës së bimëve.

### Shembuj praktikë:



**Allium ursinum** mbledhni disa gjethe nga secila bimë, duke lënë llambën dhe disa gjethe për fotosintezë dhe riprodhim.



**Panax spp.** mbledhni bimë të pjekura dhe shpërndani manaferrat në habitat për të ndihmuar rimbjelljen natyrale.



**Matricaria chamomilla** mbledhni vetëm lulët, duke lënë kërcellin dhe gjethet të papjekura për të ruajtur shëndetin e bimës.



**Sambucus nigra** mbledhni vetëm tufa të pjekura dhe lini të papjekurat për t'i lejuar të pihen dhe të përhapin farat.



**Verbascum thapsus** mbledhni gjethe nga shumë bimë, duke lënë gjethe të mjaftueshme për secilin bimë që të vazhdojë të lulëzojë.

# KREDI E SHPEJTË MIKRO

PËR ÇDO QËLLIM BIZNES APO INDIVID

**KREDI MIKRO**

deri në **2,500,000** LEKË



## KËNDI I EKSPERTIT

# Instalimi i stacioneve elektronike të motit për bujqësinë, janë investime të mirëpritura, por vetëm nëse përdoren në praktikë janë të dobishëm



Prof. Ass. Enver Isufi, Agronom në Mbrojtjen e Bimëve dhe Bujqësinë Biologjike

Prof. Ass. Enver Isufi, Agronom në Mbrojtjen e Bimëve dhe Bujqësinë Biologjike

lime praktike dhe shumica gati u braktisën, duke mos justifikuar investimet e bëra për to.

**Cilat janë gabimet që janë bërë këto vite me këto stacione elektronike moti dhe rreziku që këto gabime të përsëriten edhe tani?**

Rreziku buron te një edukatë e jonagati e përgjithëshme, që shumë punë që nisim, nuk i çojmë deri në fund dhe kështu nuk marrim rezultatet e investimeve.

**SË PARI:** Nuk jemi të përgaditur shpirtërisht që këto inovacione t'i përdorim në praktikën e punës sonë, por mjaftohemi vetëm me lajmin që stacionet u instaluan. Nuk kemi objektiva të qarta se në cilën bimë do t'i zbatojmë, me cilën praktikë bujqësore do ta fillojmë, me cilën sëmundje apo dëmtues do të fillojmë të përdorim stacionet elektronike me programet përkatëse, p.sh. për prognozimin e sëmundjes kryesore në mollë siç është kroma së mollës, apo për modernizimin e sistemit të plehërimit, ose për modernizimin e sistemit të ujitjes dhe përdorimin profesional të burimeve ujore. Mungesa e objektivave të tilla me strategjinë e të ecurit sipas parimit “step by step”, na çon në çorientimin e punëve dhe në fund nuk finalizojmë asnjë objektiv, na ikën koha pa fiksuar asnjë përvojë për ta përgjithësuar.

**SË DYTË:** Nuk caktojmë personelin përkatës për çdo stacion të instaluar dhe nuk i trajnojmë specialistët për të përdorur zbatimin e programeve të ndryshme kompjuterike për aspekte të teknologjive inovative.

**SË TRETË:** Nuk parashikojmë buxhet për personelin dhe për mirëmbajtjen e stacioneve në raste defektesh.

**SË KATËRTË:** Vëmë re se shumica e përdoruesve nuk e kuptojnë që stacioni elektronik i motit nuk i zgjidh të gjitha punët, ajo është vetëm njëri kusht për përsosjen e teknologjive.

Ana tjetër e domosdoshme janë blerja e programeve

për aspekte të veçanta të teknologjisë së rritjes së bimëve dhe përvetësimi i tyre për qëllime interpretimi në përdorimin praktik.

Në një farë mënyre stacioni i motit është si një manjeto fon regjistruar zëri, ndërsa programet janë CD-të ose kasetat e këngëve që i vendosim manjeto fonit. Çfarë kënge t'i vendosësh manjeto fonit, atë melodi do të dëgjosh.

Pra na duhet një kombinim i personave që do të përdorin programin e elementëve të klimës të stacionit të motit, që këtë më mirë e bëjnë ekspertët e IT-së (Teknikës Informacioni) dhe eksperti agronom, i cili përzgjedh programet dhe i interpreton ato për të formuluar mesazhe për fermerët.

Një shembull tjetër për të kuptuar këtë bashkëpunim është rasti i një grafie ose skanimi që bën eksperti i radiografisë një këmbë ose dore të thyer aksidentalisht dhe mjekut që do të lexojë filmin e grafisë.

Pra ky lloj kombinimi duhet të ndodhë edhe në përdorimin e stacioneve të motit dhe programeve të teknologjive inovatore. Shkurt zotërimi i programit kompjuterik duhet të lidhet me interpretimet agronomike sipas rastit ku përdoret programi (mbrojtje bimëve, ulitje, plehërim etj.).

Defektet tona të deritanishme kanë qenë se stacionet e deritanishme të instaluar nuk e kanë pasur këtë ndërthurje të ekspertizës.

Më mirë deri më sot ka shërbyer stacioni elektronik i motit në Korçë, i cili menaxhohet kohët e fundit nga Universiteti Bujqësor i Korcës me ekspert zotin Aurel Grabocka.

Pra si përfundim në këtë moment unë si specialist që kam një përvojë modeste në këtë fushë, ndihem i gëzuar kur shikoj se numri i stacioneve elektronike të motit po shtohen me shpejtësi, por po përjetoj edhe frikën se punët nuk do të shkojnë deri në fund.

Më mirë më pak stacione të instaluar, por të funksionojnë për qëllime praktike, se sa instalimi i disa stacioneve elektronik të motit, thjeshtë për “të elektrizuar” opinionin se po ecim drejt dixhitalizimit të bujqësisë.

## Në fotot e mëposhtme:

### Disa nga stacionet e para elektronike të motit të instaluar në disa vende të Shqipërisë

Viti 2000, Enver Isufi dhe Petrit Zorba duke instaluar stacionin e motit në Institutin e Mbrojtjes së Bimëve, Durrës

Viti 2012. Enver Isufi në stacionin e motit të Institutit të Bujqësisë Biologjike, Durrës, i cili vizitohet nga specialistet e Korcës



Stacion Agrometeorologjik elektronik instaluar në I.M.B. Durrës në vitin 2000



Viti 2012. Enver Isufi (në mes të fotos) dhe Nevion Telha (QTTB, Korçë) instalojnë stacionin e motit.



2019. Specialistët Marjan dhe Iven Pepa (Durrës), duke instaluar stacionin e motit të Shkollës së Mësimi Bujqësor, Bushat, Shkodër.

## BUJQËSI

# Denaj: Skema Kombëtare e Investimeve fuqizon fermat familjare

Me një përvojë prej mbi 35 vitesh në bujqësi dhe një trashëgimi familjare që i ka rrënjët thellë në tokën e Shkodrës, Fasli Bajrami është një nga fermerët model që po kontribuon në zhvillimin e qëndrueshëm të sektorit bujqësor në Shqipëri.

Ai menaxhon 7 dynymë sera moderne, ku kultivon një gamë të gjerë perimesh të freskëta dhe cilësore, të gjitha “Made in Albania”, nisur nga sallata e deri te luleshtrydhet, domatja, kastaveci, specat dhe patëllxhanët.

Ferma e tij funksionon si një biznes i mirëfilltë familjar, ku të gjithë anëtarët e familjes kontribuojnë çdo ditë në proceset e prodhimit dhe përpunimit, duke gjeneruar të ardhura të qëndrueshme dhe duke dhënë një shtysë të rëndësishme për ekonominë lokale.

Ky sukses është bërë i mundur jo vetëm falë përvojës dhe përkushtimit të Bajramit, por edhe përmes mbështetjes së Skemës Kombëtare të Investimeve.

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Anila Denaj

bëri të ditur se përmes kësaj skeme, ai ka përfutur financim të kombinuar që përfshin një grant prej 50% dhe një kredi të butë me normë interesi vetëm 2%, e shoqëruar me garanci sovraane që mbulon deri në 70% të kolateralit.



“Kjo formulë e financimit ka bërë të mundur zgjerimin dhe modernizimin e aktivitetit bujqësor, duke shtuar rendimentin dhe cilësinë e prodhimit”, theksoi ministria.

Skema Kombëtare e Investimeve po shndërrohet në një in-

strument kyç për zhvillimin rural dhe modernizimin e bujqësisë në Shqipëri. Rasti i Fasli Bajramit është dëshmi konkrete se si mbështetja e synuar dhe e strukturuar e shtetit, kur kombinohet me përvojën dhe përkushtimin e fermerëve, jep rezultate të prek-

shme dhe të qëndrueshme.

Fermerët në të gjithë vendin jo vetëm që po kontribuojnë në sigurinë ushqimore dhe ekonomike vendase, por edhe përforcojnë besimin se bujqësia është dhe mbetet një sektor me potencial të madh zhvillimi për vendin.

# MBZHR: Prodhimi vendas i grurit, furnizim i tregut me produkte cilësore Made in Albania

Në fermën e Eduard Doçit në Kukës ka nisur korrija e grurit në një sipërfaqe prej 2.5 hektarësh.

Ministria e Bujqësisë dhe

Zhvillimit Rural, Anila Denaj ndau në rrjete sociale pamje nga ferma e Eduard Doçit, ndërsa tha se “prodhimi shkon në tregun vendas, duke kon-



tribuar jo vetëm në furnizimin me produkte cilësore Made in Albania, por edhe në forcimin e ekonomisë familjare dhe asaj vendase”.

Qeveria po vijon mbështetjen e fermerëve me qëllim që të rrisin kapacitetin dhe cilësinë prodhuese në agropërpunim, modernizimin e mekanikës bujqësore, agroturizmin, peshkimin, akuakulturën, etj.

Përmes Skemës Kombëtare të Investimeve, me 50% grant dhe mbështetjes nga Kredia e Butë të kombinuar me Garancinë Sovraane, çdo fermer mund të përfitojë financim me normë interesi vetëm 2% dhe mbulim kolateral deri në 70%.

Së fundmi qeveria miratoi një Garanci Sovraane me fond prej 3 miliardë lekësh, një instrument i cili do të vihet në shërbim të fermerëve me qëllim lehtësimin e aksesit në financë.

# Albaponik, revolucionarizimi i bujqësisë së qëndrueshme në Shqipëri me mbështetjen e BE-së



Një det bimësh të gjelbra shtrihet në mbi 3.000 metra katrorë hapësirë kultivimi të optimizuar. Marule, bimë mjekësore dhe perime pa pesticide rriten në kodrat e Baldushkut pranë Tiranës, aty ku ferma Albaponik po revolucionarizon mënyrën se si prodhohet ushqimi i freskët duke përdorur teknologji hidroponike të përparuar dhe duke kultivuar kultura me cilësi të lartë.

Vite më parë, ndërsa shoqëritë u bënë gjithnjë e më të vetëdijshme për dëmet e pesticideve dhe përdorimit të tepërt të ujit, një fermë si kjo do të dukej si një ëndërr e së ardhmes. Valbona Duro kujton se si lindi ideja. “Lindi nga një pasion i madh për inovacion të qëndrueshëm. Duke parë problemet në rritje të degradimit të tokës, përdorimit të tepërt të pesticideve dhe bujqësisë së prekur nga klima, ndiem një nevojë të fortë për të ofruar një alternativë më të mirë”, thekson ajo.

Kultivimi i bimëve mjekësore pa dhe mund të jetë jo vetëm i shëndetshëm, por edhe

miqësor ndaj mjedisit, pasi sistemet hidroponike ofrojnë përfitime të shumta shende-



tësore dhe ekologjike. Ato prodhojnë ushqim të freskët dhe të shëndetshëm dhe rrisin vlerën ushqyese të të korrave falë llambave të specializuara LED. Këto llamba nxisin fotosintezën e klorofilit në bimë, duke nxitur rritjen e tyre dhe duke përmirësuar shijen e produkteve. Duke kombinuar qëndrueshmërinë, efikasitetin dhe cilësinë, sistemi hidro-

ponik mundëson prodhim të besueshëm pavarësisht kushteve të motit, duke siguruar që çdo kulturë të përmbushë standardet më të larta të shëndetit dhe shijes.

“Albaponik përdor një sistem hidroponik riqarkullues, ku bimët rriten në ujë të pasuruar me lëndë ushqyese në vend të dheut. Ky ujë filtrohet dhe ripërdoret vazhdimisht, duke çuar minerale jetësore direkt në rrënjë, si dhe duke minimizuar mbetjet. Sistemi ynë përputhet në mënyrë të përkryer me Agjendën e Gjellbër Evropiane, pasi zvogëlon përdorimin e ujit deri në 90% krahasuar me bujqësinë tradi-

cionale, duke e bërë atë si miqësore me mjedisin ashtu edhe të qëndrueshme”, thotë Valbona Duro nga Albaponik.

Ferma ka marrë mbështetje nga projekti “BE për Inovacionin” për të përmirësuar mikroklimën e saj, për të siguruar burime energjie, për të automatizuar dhe digjitalizuar operacionet, si dhe për të rritur efikasitetin e shpërndarjes. Kjo



ka mundësuar prodhim gjatë gjithë vitit, kohë më të shpejta shpërndarjeje, furnizim të pandërprerë me energji dhe kontroll të saktë operacional.

“Ky është një shembull se si po i mbështesim sipërmarrjet e reja në Shqipëri që të bëhen të qëndrueshme. Mund ta shihni sa i bukur është ky vend, sa të shëndetshme janë marulet, domatet dhe specat - dhe të gjitha janë rritur pa mbetje. Jam shumë krenar për këtë program, i cili mbështet 40 biznese në Shqipëri që të jenë të qëndrueshme. Ata përdorin inovacionin, sepse inovacioni është e ardhmja e Shqipërisë. Kjo është mënyra për të gjetur hapësira ku bizneset shqiptare mund të bëhen konkurrese pasi Shqipëria të anëtarësohet në BE. Kjo është edhe një mënyrë e mirë për t'i siguruar bujqësisë shqiptare zhvillim të qëndrueshëm, sepse bujqësia këtu drejtohet kryesisht nga fermerët e vegjël dhe ata duhet të gjejnë hapësira ku mund t'u shërbejnë konsumatorëve dhe gjithashtu të jenë në gjendje të eksportojnë”, tha

Ambasadori i BE-së në Shqipëri, Silvio Gonzato, gjatë një vizite në Albaponik.

Ndërsa valët e këtij deti të gjellbër shkëlqejnë nën diell dhe zhurma e ujit që rrjedh dëgjohet në të gjithë fermën, ku strukturat e bardha janë elementët e vetëm që thyjnë gjelbërimin e pafund, të duket sikur po rri në mes të një laboratorit dhe pyet



veten: pse këto bimë konsiderohen kaq të shëndetshme?

“Në Albaponik, ne kultivojmë ushqime pa pesticide

dhe herbicide. Mjedisin ynë i kontrollojmë dhe shpërndarja e saktë e lëndëve ushqyese sigurojnë që bimët të rriten natyrisht, me vlerën maksimale ushqyese dhe pa mbetje kimike. Rezultati? Prodhime të freskëta, të shijshme dhe vërtet të shëndetshme, të cilave mund t'u besoni”, shpjegon Duro, duke vënë në dukje se metoda e kontrolluar ruan vazhdimisht vlerat ushqyese.

Albaponik kultivon një përzgjedhje të larmishme jeshillëqesh, bimësh mjekësore dhe zarzavatesh. Ata i shërbejnë një tregu në rritje duke bashkëpunuar me zinxhirë supermarketes, dyqane ushqimesh organike, restorante vendore dhe konsumatorë të ndërgjegjshëm për mjedisin. “Këto partneritete na ndihmojnë të sigurojmë kërkesë të qëndrueshme dhe njohje të fortë të markës në sektorin e produkteve të freskëta”, thotë Duro. Aroma e borzilokut

të freskët mbush fermën, duke e shndërruar atë në një kopsht të madh që ngjall kujtime të shtëpive të fëmijërisë në fshat.

## “Shendeverë” vendos Shqipërinë në hartën e verërave

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Anila Denaj, theksoi se produktet “Made in Albania” po fitojnë gjithnjë e më shumë terren në tregjet elitare ndërkombëtare.

Një shembull në këtë drejtim është Kantina e Verës Çobo, me të cilën Shqipëria u prezantua në panairin prestigjioz CEE Wine Fair në Londër.

Në një masterclass të zhvilluar nga eksperti britanik i verës, Will Hill, vëmendjen e mori veçanërisht vera Shendeverë Méthode Champenoise.

Eksperti nuk ngurroi ta vlerësonte lart, duke deklaruar se kantina “Çobo” e ka vendosur Shqipërinë në hartën e verërave.

Përveç Shendeverës, në panair u prezantuan edhe verërat

“E Bardha e Beratit”, e bërë me varietetin lokal Puls, dhe

cilësinë e lartë të produkteve të Kantinës Çobo, duke theksuar



“E Kuqja e Beratit” me rrushin autokton Vlosh.

Këto verëra impresionuan të pranishmit dhe konfirmuan

njëkohësisht rolin kyç të saj në promovimin e trashëgimisë shqiptare të verës në arenën ndërkombëtare.

## Fermerja nga Kavaja që përfitoi 30% parapagim nga Skema e Investimeve, ndërtoi serrën e perimeve për eksport

Gentjana Dupi, në Kazz të Kavajës, është një ndër fermeret përfituese nga Skema Kombëtare e Investimeve, për ndërtimin e një serre diellore për kultivimin e perimeve.

Drejtoresha e Agjencisë për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural, Ardita Kuçi vizitoi nga afër fermën e Gentjanës, teksa vuri në dukje se “investimi në këtë serrë, me një sipërfaqe prej 1 hektar, ka si destinacion tregun e jashtëm”.

Kuçi tha se, Gentjana e nisi investimin duke përfituar 30% parapagesë, dhe për të vijuar më tej, ka aplikuar edhe për Kredinë e Butë në bujqësi.

“Skema Kombëtare e Investimeve është një mbështetje konkrete për të gjithë fermerët që duan të modernizojnë apo zgjerojnë aktivitetin e tyre”, tha Kuçi.

Ajo bëri të ditur se, me 50% grant nga Skema Kombëtare e Investimeve dhe mbështetjes nga Kredia e Butë, e kombinuar me Garancinë Sovrane, fermerët dhe bizneset në bujqësi mund të përfitojnë financim me normë interesi vetëm 2% dhe mbulim kolaterali deri në 70%.

Gentiana tregoi se aplikoi shumë lehtë për mbështetje nga Skema Kombëtare e Investimeve.

“Përfitova 30% parapagim dhe nisa menjëherë me in-

vestimin, duke ndjerë lehtësim të kostove. Kam aplikuar për Kredi të Butë në bankat e nivelit të dytë, e kombinuar me Garancinë Sovrane, që do të më ndihmojë të çoj përpara investimin”, tha Gentiana.

Prej vitit 2018, qeveria ka rritur ndjeshëm vlerën në para në mbështetje të investimeve në bujqësi. Në vitin 2024 është nisi zbatimin skema kombëtare e investimeve me një buxhet 15 milionë euro ndërsa në 2025 qeveria pritet të miratoj skemën e re të investimeve për bujqësinë dhe blegtorinë me 9 programe, me vlerë 20 milionë euro me kohështrirje 2-vjeçare.

## Integrimi në BE - Së shpejti hapet grupkapitulli katër për Shqipërinë

Shqipëria shënon një tjetër hap të rëndësishëm në rrugën e integrimit drejt Bashkimit Europian dhe brenda muajit qershor pritet të hapë grupkapitullin e katërt.

"Sot, më 11 qershor 2025, pasi ka konstatuar se Shqipëria është mjaftueshëm e përgatitur për të hapur negociatat, Komiteti i Përfaqësuesve të Përhershëm të 27 vendeve anëtare të Bashkimit Evropian, autorizoi Presidencën e BE-së dhe Presidenca Polake i dërgoi sot letërën Shqipërisë ku i kërkon të paraqesë pozicionin e saj negociues mbi katër kapitujt e përfshirë në Grupkapitullin 4 “Agjenda e Gjelbër dhe Ndërlidhja e Qëndrueshme”. Pozicioni negociues do t'i paraqitet Konferencës së Gjashtë Ndërqeveritare me Shqipërinë, e cila do të organizohet në një datë që do të shpallet së shpejti nga Presidenca e Këshillit të Bashkimit Evropian.

Kapitujt e Grupkapitullit 4 përfshijnë fusha shumë të rëndësishme për ekonominë, biznesin dhe që prekin drejtpërdrejt jetën e përditshme të qytetarëve dhe janë faktor transformimi për zhvillimin afatgjatë të vendit.

Kapitulli 14, i cili trajton politikën e transportit, synon përmirësimin e infrastrukturës dhe sigurisë rrugore e hekurudhore;

Kapitulli 15 lidhet me sektorin e energjisë dhe garantimin e furnizimit të qëndrueshëm dhe të përbalueshëm me energji;

Kapitulli 21 fokusohet te rrjetet trans-evropiane dhe ndërlidhjen infrastrukturore të Shqipërisë me vendet e BE-së, si pjesë e rëndësishme e Korridorëve Evropiane; ndërsa Kapitulli 27 vlerëson mbrojtjen e mjedisit dhe përbalimin e ndryshimeve klimatike, përmes standardeve të larta të BE-së.

Përmes negociatave të këtyre kapitujve, Shqipëria pritet të bëjë hapa konkretë drejt ndërtimit të rrugëve më të sigurta dhe moderne, përmirësimit të ndërlidhjes rajonale dhe evropiane, garan-

timit të furnizimit me energji të pastër dhe të përbalueshme, si dhe mbrojtjes së mjedisit për gjeneratat e ardhshme.

Ky është një investim i drejtpërdrejtë në cilësinë e jetës së qytetarëve shqiptarë dhe transformimin e pandalshëm të ekonomisë shqiptare në rrugën drejt familjes evropiane.

Ky vendim i Bashkimit Evropian konfirmon ecurinë e suksesshme të Shqipërisë në procesin e anëtarësimit. Ai është një tregues i qartë i përparimit të prekshëm në përmirësimin e reformave ekonomike, i përgatitjes dhe aftësive të të gjitha institucioneve shqiptare dhe aktorëve ekonomik, si dhe Ekipit Kombëtar të Negociatave për anëtarësim, por njëkohësisht përforcon besimin se Bashkimi Evropian mbështet një proces zgjerimi të drejtë dhe të besueshëm, të bazuar në rezultate konkrete, të matshme dhe përmirësim të standardeve evropiane”, thuhet në njoftim.

## Peshkatarët e Shëngjinit zgjedhin markatën për tregtimin e kontrolluar të peshkut

Markata e peshkut në Shëngjin po kthehet gjithnjë e më shumë në një pikë referimi për tregtimin e organizuar, të kontrolluar dhe me standarde të produkteve të detit.

E ndërtuar si një investim i Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (MBZHR) dhe aktualisht e administruar nga bashkia Lezhë, përmes ndërmarrjes publike “Lezha Invest”, kjo markatë ofron një qasje të re dhe funksionale për sektorin e peshkimit në Shqipëri.

Administratori i “Lezha Invest”, Besmir Frroku vlerësoi faktin se tashmë subjektet po ndërgjegjësohen dhe po e sjellin gjithë prodhimin e tyre

në markatë, duke u larguar nga mënyrat informale të tregtimit. Sipas tij, bashkëpunimi me institucionet përkatëse është thelbësor për të vijuar me rritjen e ndërgjegjësimit publik mbi rëndësinë e konsumit të produkteve të certikuara.

“Subjektet kanë filluar të ndërgjegjësohen dhe të sjellin të gjithë peshkun në markatën e peshkut. Kërkojmë më shumë bashkëpunim, veçanërisht nga institucionet përkatëse, në mënyrë që njerëzit të kuptojnë rëndësinë e peshkut të certifikuar”, theksoi Frroku.

Ai shtoi se interesimi nga ana e peshkatarëve është në rritje, pasi kjo formë tregtimi u ofron atyre një kanal të sig-

urt, të mbikëqyrur dhe të ndershëm për shitjen e prodhimeve të tyre.

“Ne monitorojmë të gjithë procesin, sepse anijet do të marrin certifikimin, dhe njerëzit do të kenë një treg ku mund të marrin peshk sipas të gjitha standardeve”, shprehet administratori.

Markata e Shëngjinit po funksionon edhe si pikë grumbullimi dhe shitjeje, duke garantuar cilësinë dhe gjurmueshmërinë e produkteve detare.

Kjo nismë ndihmon në formalizimin e tregut të peshkut, rrit besimin e konsumatorëve dhe ka një ndikim pozitiv në mbrojtjen e shëndetit publik.

## Skema Kombëtare e Investimeve, fermeri në Ishull Lezhë përfiton traktor

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Anila Denaj vizitoi fermën e Frano Gjergjit në Lezhë.

Frano Gjergji është një fermer me përvojë që administron 62 dynmë tokë bujqësore, ku 40 dynmë janë të mbjella me misër dhe pjesa tjetër me kultura foragjere.

Me mbështetjen nga Skema Kombëtare e Investimeve 2024, Frano ka përfituar traktor bujqësor, duke sjellë një transformim të dukshëm në ritmin dhe cilësinë e punimeve agroteknike.

Mekanizimi i fermës ka rritur efikasitetin, ka reduktuar kostot dhe ka mundësuar një menaxhim më të mirë të sezonit të mbjelljeve dhe korryes.

“Punojmë në bujqësi. Mbajmë misër shumë. Kemi

aplikuar dhe kam përfituar në sajë të qeverisë”, thotë ai.

të Investimeve, me 50% grant dhe mbështetjes nga Kredia



Përfitues i mekanikës bujqësore. Skema Kombëtare e Investimeve

“Aplikoni për bujqësinë. Punoni për bujqësinë sepse është baza kryesore këtu që punohet dhe jetohet”, ishte apeli i tij.

Përmes Skemës Kombëtare

e Butë të kombinuar me Garancinë Sovrane, çdo fermer mund të përfitojë financim me normë interesi vetëm 2% dhe mbulim kolateral deri në 70%.

## Tregti e lirë elektronike në rajon - Çfarë përfshin marrëveshja midis Shqipërisë dhe vendeve të CEFTA për shitjet online?

Harmonizimi i ligjeve të tregtisë elektronike në të gjithë rajonin dhe përafrimi i tyre me Bashkimin Evropian, me qëllim rritjen apo lehtësimin e lëvizjes së lirë të mallrave dhe shërbimeve në të gjithë rajonin është synimi kryesor i projektligjit të depozituar në Kuvend për ratifikimin e vendimit të vitit 2024, të Komitetit të Përbashkët të Marrëveshjes së Tregtisë së Lirë të Evropës Qendrore (CEFTA), “Për lehtësimin e tregtisë elektronike”.

Ky projektligj synon ndër të tjera rritjen e mbrojtjes së konsumatorit nga abuzimet që mund të ndodhin prej bizneseve që shesin produkte online.

Në rast mosmarrëveshje midis një biznesi që shet dhe qytetarit që merr shërbimin

apo produktin, ata do të kenë mbështetje legjislative dhe mosmarrëveshja mund të zgjidhet në mënyra jashtëgjyqësore.

Sipas projektligjit, konsumatori, pavarësisht se ka hyrë në një marrëdhënie kontraktore në largësi, do të ketë një periudhë 14-ditore për t'u tërhequr nga një kontratë në distancë, pa dhënë arsye dhe pa shkaktuar ndonjë kosto tjetër. Pra, nëse dikush ka bërë një blerje online, ka të drejtë që brenda 14-ditëve ta ndërpresë porosinë ose ta kthejë produktin e marrë. Klienti mund të rimbursohet plotësisht brenda 14 ditëve nga tregtari, por produkti duhet të jetë në gjendje të mirë kur të kthehet.

Nëse produkti humbet ose dëmtohet gjatë transportimit të siguruar nga tregtari,

përgjegjësinë do e mbajë ky i fundit, por nëse transportuesi është siguruar nga konsumatori për të transportuar mallrat dhe nuk ishte ofruar nga tregtari, atëherë përgjegjësinë do e mbajë qytetari.

Biznesi duhet të dorëzojë mallrat, duke transferuar zotërimin fizik ose kontrollin e mallrave te konsumatori pa vonesa, brenda 30 ditëve nga kryerja e porosisë, me përjashtim të rasteve ku palët kanë rënë dakord për një afat tjetër.

Nëse malli nuk dorëzohet brenda kësaj periudhe, nëse e lejojnë rrethanat, mund të shtyhet dorëzimi me një periudhë shtesë. Nëse përsëri malli nuk dorëzohet, konsumatori ka të drejtë të anulojë porosinë dhe tregtari i kompenson atij shumën e paguar.

Pamja e qiellit gjatë muajit Korrik 2025

Më 4 korrik - Mërkuri në zgjatimin më të madh lindor. Planeti Mërkuri arrin zgjatimin

Kalendari bujqësor, muaji korrik 2025

Përgatitur nga Prof. As. Dr. Eqrem Meçollari

dit, mesatarisht, vetëm 6 ditë ishin me shi. Tirana në korrik do të përjetojë ditë përvëluese me qiell pak të vranët. Zakonisht, temperatura do të luhatet


Parashikimi i motit për muajin korrik 2025 në Tiranë (Zona bregdetare)

| Dt. | Temperatura e ajrit °C |    | Temp. reale që ndjehet °C | Shiu |     | Era    |    |          |     | UV Indeks | Përshkrimi i shkurtër i motit               | Simboli                                                                              |
|-----|------------------------|----|---------------------------|------|-----|--------|----|----------|-----|-----------|---------------------------------------------|--------------------------------------------------------------------------------------|
|     | U                      | L  |                           | mm   | Orë | Km/Orë |    | Drejtimi |     |           |                                             |                                                                                      |
|     |                        |    |                           |      |     | D      | N  | D        | N   |           |                                             |                                                                                      |
| 1   | 19                     | 35 | 20-40-35                  | 0    | 0   | 9      | 4  | P        | JJP | 10        | Diell dhe nxehtë                            |    |
| 2   | 23                     | 33 | 24-37-33                  | 0    | 0   | 6      | 6  | VL       | VVP | 10        | Diell                                       |    |
| 3   | 22                     | 32 | 25-37-33                  | 0    | 0   | 6      | 6  | VL       | VVL | 10        | Kohë me diell                               |    |
| 4   | 23                     | 33 | 24-37-33                  | 0    | 0   | 6      | 7  | JJL      | JJL | 10        | Kryesisht me diell                          |    |
| 5   | 23                     | 33 | 24-37-33                  | 0    | 0   | 6      | 6  | JJL      | VVP | 10        | Kohë me dilla dhe pak re                    |    |
| 6   | 23                     | 32 | 33-37-32                  | 0    | 0   | 6      | 4  | L        | JP  | 10        | Diell                                       |    |
| 7   | 23                     | 33 | 27-37-32                  | 0    | 0   | 7      | 6  | JJL      | VVP | 10        | Kryesisht me diell                          |    |
| 8   | 23                     | 32 | 22-35-31                  | 2.9  | 1.5 | 9      | 11 | VL       | VVL | 10        | Rritje e vranësirës me disa shira dhe stuhi |    |
| 9   | 22                     | 29 | 21-33-28                  | 0    | 0   | 9      | 9  | VVL      | V   | 10        | Pa lagështi dhe plot me diell               |    |
| 10  | 22                     | 29 | 21-34-28                  | 0    | 0   | 6      | 7  | VL       | V   | 10        | Plot me diell                               |    |
| 11  | 22                     | 30 | 21-35-29                  | 0    | 0   | 6      | 9  | VL       | V   | 10        | Plot me diell                               |    |
| 12  | 23                     | 31 | 22-36-30                  | 0    | 0   | 6      | 7  | VL       | V   | 10        | Plot me diell                               |    |
| 13  | 23                     | 33 | 25-37-32                  | 0    | 0   | 6      | 6  | JJL      | PJP | 10        | Plot me diell                               |   |
| 14  | 23                     | 33 | 24-37-32                  | 0    | 0   | 6      | 6  | JJL      | JL  | 10        | Plot me diell                               |  |
| 15  | 23                     | 32 | 25-37-32                  | 0    | 0   | 6      | 6  | LVL      | PJP | 10        | Kohë me diell                               |  |
| 16  | 23                     | 33 | 24-38-33                  | 0    | 0   | 6      | 6  | JJL      | VVP | 10        | Diell i bollshëm                            |  |
| 17  | 23                     | 33 | 27-38-34                  | 0    | 0   | 6      | 7  | VL       | VVP | 10        | Diell i shndritshëm                         |  |
| 18  | 23                     | 34 | 25-38-34                  | 0    | 0   | 6      | 6  | VL       | VVP | 10        | Diell                                       |  |
| 19  | 23                     | 33 | 25-38-34                  | 0    | 0   | 4      | 7  | LVL      | V   | 10        | Diell                                       |  |
| 20  | 24                     | 33 | 23-37-33                  | 0    | 0   | 7      | 7  | VL       | VVL | 10        | Kryesisht me diell                          |  |
| 21  | 24                     | 32 | 23-36-31                  | 0    | 0   | 9      | 7  | VVL      | V   | 10        | Kohë me diell                               |  |
| 22  | 23                     | 32 | 21-35-30                  | 1.7  | 1   | 9      | 6  | VVL      | LVL | 10        | Kryesisht me diell                          |  |
| 23  | 23                     | 32 | 23-35-31                  | 1.1  | 1   | 7      | 6  | LVL      | L   | 10        | Kryesisht me diell                          |  |
| 24  | 23                     | 31 | 22-36-30                  | 1.7  | 1   | 7      | 7  | VL       | VL  | 10        | Kryesisht me diell                          |  |
| 25  | 23                     | 32 | 23-36-31                  | 0    | 0   | 7      | 6  | VL       | V   | 10        | Diell                                       |  |
| 26  | 24                     | 32 | 23-37-32                  | 0    | 0   | 6      | 7  | VVL      | V   | 10        | Kohë me diell                               |  |
| 27  | 24                     | 34 | 24-38-34                  | 0    | 0   | 6      | 7  | VL       | VVL | 9         | Kohë me diell                               |  |
| 28  | 24                     | 34 | 23-38-33                  | 0    | 0   | 6      | 9  | VL       | V   | 9         | Diell i bollshëm                            |  |
| 29  | 24                     | 34 | 24-37-33                  | 0    | 0   | 7      | 6  | VL       | VVL | 9         | Kryesisht me diell                          |  |
| 30  | 24                     | 34 | 24-39-34                  | 0    | 0   | 6      | 6  | VVL      | VVL | 9         | Diell                                       |  |
| 31  | 24                     | 34 | 24-38-34                  | 0    | 0   | 6      | 7  | VL       | VL  | 9         | Diell                                       |  |


Treguesit mesatarë klimatike gjatë muajit korrik 2025

| Treguesit                                          | Tiranë      | Korçë       | Vlorë       | Shkodër     | Dibër       | Gjirokastrë |
|----------------------------------------------------|-------------|-------------|-------------|-------------|-------------|-------------|
| Temperatura e ajrit                                |             |             |             |             |             |             |
| Mesatare (°C)                                      | 28          | 25          | 28          | 29          | 21          | 25          |
| Maksimale (°C)                                     | 31          | 28          | 29          | 33          | 26          | 30          |
| Minimale (°C)                                      | 26          | 21          | 26          | 26          | 15          | 21          |
| Më e larta gjatë viteve (°C)                       | 41 (2021)   | 37 (2009)   | 36 (2015)   | 42 (2015)   | 34 (2009)   | 40 (2021)   |
